



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nënkomisioni Parlamentar “Për ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat””

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.09.2018.
2. Vijueshmëria e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Marrin pjese:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Të ftuar:

Julian Hoda – Zëvendësministër i Brendshëm

Aida Shehi – Drejtoreshë e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita! Në fakt, sot është përcaktuar të zhvillohet edhe mbledhja e nënkomisionit të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”. Sipas asaj që është bërë e ditur edhe në mbledhjen e mëparshme të këtij nënkomisioni, ai përbëhet në mënyrë proporcionale nga anëtarë të maxhorancës dhe të opozitës, por opozita, edhe pse flet për veting gjithë ditën, as nuk denjuar të propozojë emrat e anëtarëve, të cilët do të përfaqësonin atë në nënkomisionin për vetingun e Policisë së Shtetit.

Sidoqoftë, kalojmë në rendin e ditës të mbledhjes së sotme. Pikë e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 21 shtator 2018. Kush është dakord me procesverbalin? Faleminderit!

Pikë e dytë e rendit të ditës së kësaj mbledhjeje është vijueshmëria e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Të ftuar në këtë mbledhje kemi zotin Julian Hoda, zëvendësministër i Brendshëm. Mirë se erdhët, zoti Hoda! Gjithashtu, në mbledhje kemi edhe zonjën Aida Shehi, drejtoreshë e Shërbimeve Mbështetëse.

Përpara se ju të merrni fjalën lidhur me zbatimin e ligjit në fjalë, dua të informoj kolegët e nënkomisionit, por edhe publikun në mënyrë të përmbledhur. Në datën 4 prill ka hyrë në fuqi ligji nr. 12 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”. Në bazë të nenit 5 të këtij ligji, organet e vlerësimit kalimtar janë: Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, Komisioni Qendror i Vlerësimit, Komisioni Vendor i Vlerësimit. Organet e vlerësimit kalimtar organizohen në trupa vlerësimi dhe çdo trupë vlerësimi përbëhet nga tre anëtarë, të cilët caktohen me short nga komisioni përkatës i vlerësimit.

Dua të them dy fjalë për Bordin e Përzgjedhjes dhe për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit që janë dy struktura, të cilat sipas ligjit duhet të iniciojnë fazën e parë fillestare të vetingut në

radhët e Policisë së Shtetit dhe bëhet fjalë për vetimin e të gjitha gradave të larta në Policinë e Shtetit, të cilat shkojnë diku rreth 300 grada, në mos gaboj.

Bordi i Përzgjedhjes është hallka e parë që do të duhet të kemi për zbatimin e ligjit. Për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe të sekretariatit teknik pranë këtij komisioni ngrihet bordi i përzgjedhjes. Ky bord përbëhet nga pesë anëtarë përfaqësues, nga Ministria e Brendshme, dhe ky përfaqësues drejton edhe bordin, nga Avokati i Popullit; nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga Shërbimi Informativ Shtetëror dhe nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pra, kjo është përbërja e Bordit Përzgjedhës. Ndërkohë, anëtarët e këtij bordi caktohen nga titullarët e institucioneve, të cilave u përkasin, kuptohet nga radhët e nëpunësve të lartë drejtues të këtyre institucioneve. Ndërkohë, përbërja e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, sipas nenit 9 të ligjit për vetingun në radhët e policisë përbëhet nga 15 anëtarë, 5 anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit caktohen nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Natyrisht, përzgjidhen nga punonjësit e këtij institucioni sipas kriterëve që ka ligji së bashku me dy anëtarë zëvendësues, të cilët, në rast mungese të anëtarëve të zgjedhur, plotësojnë këtë mungesë.

10 anëtarët e Komisionit të Jashtëm përzgjidhen nga Bordi i Përzgjedhjes. 5 anëtarë të këtij komisioni përzgjidhen nga 10 pedagogë të universiteti të Tiranës me propozim të rektorit të institucionit. Për këtë qëllim dekanët e fakulteteve të drejtësisë, ekonomisë dhe shkencave sociale i propozojnë rektorit nga 5 pedagogë secili. Ndërkohë, 5 anëtarët e tjerë të komisionit përzgjidhen me konkurrim të hapur, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Pra, nga 10 përfaqësues 5 zgjidhen nga propozimet që vijnë nga të gjitha fakultetet, kurse 5 të tjerët me konkurrim të hapur. Bordi Përzgjedhës përzgjedh nga kandidaturat e paraqitura apo nga aplikantët edhe katër anëtarë zëvendësues për të njëjtën arsye që u tha edhe pak më parë. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, e cila është trupa e parë që do të fillojë punën, pra vetingun në Policinë e Shtetit, organizohet në 5 trupa vlerësimi me tre anëtarë secila. Nuk po i lexoj të gjitha parashikimet e ligjit, sepse besoj se na duhet të informohemi, së pari, nga ju dhe më pas nëpërmjet pyetjeve, që do të kenë kolegët, të kuptojmë nëse ka filluar zbatimi i ligjit dhe deri në çfarë momenti keni mbërritur nga ju dhe si pritët të vijojë me qëllim që të fillojë vetimi real i punonjësve të Policisë së Shtetit.

Faleminderit!

Fjala është për ju, zoti Hoda.

Julian Hoda – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirdita, të nderuar deputetë!

Meqë kjo është mbledhja e parë e nënkomisionit në të cilën Ministria e Brendshme merr pjesë, më lejoni t'ju informoj me ecurinë e procesit të parë nga këndvështrimi ynë si Ministri e Brendshme meqë kemi qenë përgjegjës për menaxhimin e këtij procesi. Me hyrjen në fuqi të ligjit, afati i parë dhe detyrimi i parë që lindte ishte dorëzimi i deklaratave individuale të të gjithë punonjësve. Flasim për rreth 12 mijë punonjës të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe SHÇBA-së, me qëllim asistimin, këshillimin dhe mbarëvajtjen e këtij procesi dorëzimi, i cili zgjati deri më 7 maj. Në të tria strukturat u adoptua një skemë ndihme. Për shembull, te Policia e Shtetit, më anë të urdhrat të drejtorit të Përgjithshëm u krijua një strukturë rreth 120 veta në Tiranë dhe në rrethe, ku në çdo njësi të policive vendore dhe në qendër u caktuan burimet njerëzore, juristët dhe personeli ndihmës, me qëllim asistencën e vazhdueshme të punonjësve gjatë fazës së deklarimit. Kjo strukturë përbëhej nga rreth 120 veta. Të njëjtën strukturë e adoptoi garda e Republikës, por në një shkallë më të vogël, sepse personeli ishte më i vogël në numër, dhe SHÇBA-ja, që ka edhe më pak punonjës, pati të njëjtën skemë.

Procesi i dorëzimit deri më 7 maj shkoi pa probleme. Gati 98% e punonjësve të secilës prej strukturave i dorëzuan në rregull deklaratat. Pati një 2% dorëheqje ose më saktë konstatohet një 2% dorëheqjeje gjatë muajit në të cilin duhet të dorëzoheshin deklaratat, por nuk na takon neve të paragjykojmë dorëheqjen për sa kohë as ligji nuk e paragjykon dorëheqjen e gjithkujt.

Paralelisht me fazën e dorëzimit, u procedua me ngritjen e bordit përzgjedhës që, siç e përmendët edhe ju, përbëhet nga ato pesë institucione. Nga Ministria e Brendshme iu kërkua institucioneve të tjera të caktonin anëtarë.

Janë caktuar dhe janë kryer të gjitha komunikimet e nevojshme. Mbledhja e parë e Bordit Përzgjedhës është bërë në datën 26 prill dhe është kryesuar nga Ministria e Brendshme, nga zonja Aida Shehi, që është drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, e cila është edhe kryetare e Bordit, sipas parashikimeve të ligjit. Me krijimin e Bordit u komunikua më pas edhe me institucionet e tjera, që do të thotë se u komunikua me ILDKPI-në që të caktonte 5 anëtarët dhe 2 anëtarët zëvendësues. U komunikua me universitetin në mënyrë që të sillnin 10 propozime, nga të cilat bordi duhej të përzgjidhte 5 dhe u bënë shpalljet për konkurrimin e lirë për 5 vende për anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe 15 anëtarë të sekretariatit teknik, që është mbështetës i këtij komisioni. Për sa i përket pjesës me konkurrim të lirë, pati interes nga mjaft persona. U bënë

më tepër se 150 aplikime. Janë intervistuar më tepër se 70 persona dhe bordi ka arritur në një listë renditjeje me një sistem pikëzimi të përcaktuar që më parë me vendim të bordit. Kjo do të thotë se ky proces i përzgjedhjes ka përfunduar që në datën 20 qershor. Nuk është marrë vendimi final nga bordi, sepse kjo do të thoshte se organi duhej të konstituohej dhe të fillonte menjëherë nga puna, në një kohë kur paralelisht do të duhej të zgjidheshin çështjet e trajtimit financiar dhe të sistemit logjistik.

Për sa i përket sistemimit logjistik, ju e përmendët që procesi ka tri faza. Në fazën e parë janë 30 punonjës të këtij organi të ri që duhet të sistemohen. Ministria e Brendshme ka marrë masat qoftë edhe për një sistemim të këtij organi me 30 veta, qoftë edhe për një plan afatgjatë, duke qenë se ky organ në fazën e dytë kompletohet me 90 veta dhe në fazën e tretë arrin në 270 veta. Është identifikuar godina, janë bërë projektet teknike të ristrukturimit dhe të rehabilitimit të ndërtesës; është në proces edhe prokurimi për këtë ristrukturimin e kësaj godine dhe për vënien në dispozicion të komisioneve të vlerësimit të ambienteve të punës, të cilat janë të denja për një institucion të tillë.

Për sa i përket trajtimit financiar, propozimin për pagat dhe shpërblimet, sipas ligjit, e ka Departamenti i Administratës Publike. Megjithatë, Ministria e Brendshme që në datën 29 mars ka bërë gati një draft-VKM, të cilin e ka përcjellë te DAP-i, i cili e ka shpërndarë për mendim në institucione të ndryshme dhe jemi ende në fazën e finalizimit, ose më saktë, po presim që ky vendim të finalizohet.

Skema financiare deri-diku ka qenë e parashikuar edhe te relacioni i projektligjit që është votuar. Është menduar një sistem shpërblimi për organet e vetingut, i bazuar mbi pagën e funksionarëve të policisë me disa shtesa, në mënyrë që të garantohet një pagë dinjitoze që nga një anë shërben si mekanizëm antikorrupsion, nga ana tjetër duhet të reflektojë edhe rëndësinë që ka institucioni. Kjo është në vija të përgjithshme ajo që ka ndodhur deri më sot.

Ermonela Felaj – Para se të kalojmë te pyetjet, a mund të na e bëni transparente përbërjen e Bordit të Përzgjedhjes dhe Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit?

Julian Hoda – Në lidhje me Bordin e Përzgjedhjes, besoj se po, sepse institucionet i kanë përcaktuar emrat. Në lidhje me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit dhe sekretariatit teknik, besoj se duhet të pritët vendimi final i bordit, për të cilin ju thashë që është finalizuar i gjithë procesi, por nuk është marrë ende vendimi se duhej të konstituhet direkt. Për sa u përket emrave konkretë, drejtoresha mund të thotë se cilët janë përfaqësuesit.

Ermonela Felaj – Kolegë, a jeni dakord t'ia japim fjalën drejtoreshës së Bordit, pastaj të vijojmë ne me pyetjet?

Po, zonja Shehi.

Aida Shehi – Për sa i përket përbërjes së Bordit të Përzgjedhjes, kryetari është nga Ministria e Brendshme, pra unë Aida Shehi; nga Avokati i Popullit është Sekretari i Përgjithshëm, Fatbardh Zenelaj; nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Ardiana Hala; nga Shërbimi Informativ Gjergji Semani dhe nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ardita Shehaj. Këta ishin anëtarët e Bordit Përzgjedhës. Gjithashtu, gjatë zhvillimit të takimeve kemi pasur edhe prezencë të partnerëve ndërkombëtarë, të PAMECA-s dhe të ICITAP-it, me të cilët jemi konsultuar për fazat e ndryshme të vijimit të procesit.

Ermonela Felaj – A mund të na thoni diçka më tepër për punën tuaj? Sa herë jeni mbledhur si bord?

Aida Shehi – Bordi i Përzgjedhjes është mbledhur për herë të parë më 26.04.2018 dhe e ka vijuar me mbledhje të tjera të njëpasnjëshme. Domethënë, gjithsej mund të jenë zhvilluar rreth 12 mbledhje. Duke mos pasur aktet nënligjore që rregullojnë procedurën e detajuar për sa i përket veprimtarisë së Bordit Përzgjedhës, është parë e nevojshme të konsultohemi për vendimmarrje të caktuara.

Ermonela Felaj – Kalojmë te pyetjet.

Atëherë, kolegë, pak a shumë kjo është situata që referohet nga përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme lidhur me zbatimin e ligjit për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit.

Sipas atyre që dëgjuat, sipas detyrimeve që kemi si ligjvënës dhe sipas detyrimeve që ngre ligji, dua që të marrim më shumë informacion për këtë çështje dhe në të njëjtën kohë të nxitim për një shpejtësi në drejtim të zbatimit të ligjit dhe të fillimit të vetingut në radhët e Policisë së Shtetit.

Zoti Vorpsi, fjala për ju

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Për hir të së vërtetës konstatoj me keqardhje mospjesëmarrjen e opozitës si në seancë plenare, ashtu edhe në këtë nënkomision jashtëzakonisht të rëndësishëm. Këtu dua të përmend edhe një pjesë të opozitës, Lëvizjen Socialiste për Integrim, që e ka mbështetur këtë projektligj dhe shpresoj t'i bashkohet këtij nënkomisioni.

Shqetësimi im janë afatet dhe koha e fillimit të punës së këtyre komisioneve. Zëvendësministri ishte shumë i qartë në raportimin që dha këtu, por ajo që shoh unë si shqetësim

është trajtimi financiar. Pranda dua një shpjegim nga drejtoresha që mbulon shërbimet mbështetëse.

Ermonela Felaj – Po, zoti Hoda!

Julian Hoda – Sipas ligjit nr. 10 405 të vitit 2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, në rastin konkret organi propozues për trajtimin financiar të organeve të vlerësimit kalimtar është Departamenti i Administratës Publike. Ky detyrim rrjedh nga ligji për vlerësimin kalimtar, i cili ngarkon Këshillin e Ministrave për miratimin e një VKM-je.

Pavarësisht se Ministria e Brendshme nuk ishte organi përgjegjës, ajo ka hartuar një draft fillestar dhe ka shprehur qëndrimin e saj në relacion në lidhje me atë që mendon se duhet të jetë trajtimi financiar i këtyre organeve dhe ia ka përcjellë rregullisht Departamentit të Administratës Publike. Në dijeninë tonë, DAP-i e ka qarkulluar këtë relacion për mendim në institucionet e ndryshme që kanë kompetencë dhe duhet të shprehen për këtë çështje, por jemi në pritje të finalizimit.

Ermonela Felaj- Po, Elona!

Elona Gjebrea- Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër, për sqarimin e hollësishëm!

Në fakt, ajo që kuptojmë është se bordi i përzgjedhjes e ka mbaruar detyrën e tij për sa i përket vendosjes së anëtarëve dhe mbledhjeve, ndërkohë nuk mund të flasim më shumë për sa i përket Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe sekretariatit teknik, të cilët janë gati, por ndërkohë nuk kanë zhvilluar asnjë mbledhje. Kështu që jemi në fazën e një formacioni për sa i përket bordit të përzgjedhjes, sepse këtu thuhet se ushtron veprimtarinë me partnerë ndërkombëtarë, patjetër që ata kanë qenë pjesë e mbledhjeve, por a mund të na detajoni se ku kanë konsistuar këto 12 mbledhjet që ju përmendet?

Unë kam merakun e afateve, që, duke u shtyrë dhe duke u zgjatur, do të ketë vonesa.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Po, zonja Shehi!

Aida Shehi – Atëherë, fillimisht është bërë konstituimi; është vendosur nga ana e Bordit Përzgjedhës dërgimi i letrave zyrtare ILDKPI-së dhe rektoratit; po ashtu është përcaktuar edhe përmbajtja e shpalljes për shprehjen e interesit nga jashtë për anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe për sekretariatit teknik. Jemi mbledhur për të shqyrtuar edhe aplikimet e kryera,

pasi ligji përcakton kriteret përkatëse për secilin pozicion; është bërë një vlerësim i përgjithshëm i dosjeve, nëse i plotësonin këto kriterë apo jo, gjithashtu është parë e nevojshme nga aplikimet e kryera nëse dokumentacioni nuk ka qenë tërësisht i plotë apo bindës, pasi nuk ishte përcaktuar se cili do të ishte dokumentacioni konkret që do të paraqitej nga aplikantët e jashtëm. Zyrtarisht, në mënyrë elektronike dhe nga numrat e kontaktit, është kërkuar plotësimi i dokumenteve, si për shembull, vjetërsia e punës, sepse CV-të nuk kanë qenë shumë të qarta, është bërë një vlerësim i detajuar i dosjeve dhe kanë dalë kandidatët e mundshëm për pozicion. Të gjithë këta kandidatë, si për anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, ashtu edhe ata për pozicionin e anëtarit në sekretariatit teknik, janë pritur dhe janë marrë në intervistë nga Bordi për të bërë një përcaktim më të qartë lidhur me kandidaturat, që kishin shprehur interes. Kjo ka kërkuar kohë, sepse bëhej fjalë për disa intervista, rreth 70 intervista, pasi kishte kandidatura për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, po ashtu edhe për anëtarë të sekretariatit teknik. Kjo ka qenë përmbajtja e mbledhjeve.

Ermonela Felaj – Më lejoni edhe mua të bëj disa pyetje.

Po qëndroj vetëm te faza e parë, sepse ne e dimë që, nëse nuk mbaron faza e parë e vetimit, nëse nuk vetohen gradat e larta, nuk kalohet dot te gradat e mesme dhe të ulëta. Pra, është shumë e rëndësishme që të vihet në lëvizje faza e parë, kjo edhe si një lloj modeli pune për të gjitha fazat e tjera.

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ka anëtarë që zgjidhen dhe anëtarë që caktohen, dua të di se cilët janë 5 anëtarët që ka sjellë ILDKPI-ja?

Aida Shehi – Emrat janë përcjellë brenda afateve, për momentin nuk i kam, sepse nuk e dija që do të kërkonit emra konkretë, por, nëse më jepni kohë, mund t'ju bëj prezent.

Ermonela Felaj- Ndërkohë, pyetja tjetër është e njëjtën edhe për 10 anëtarët që zgjidhen nga Bordi, 5 anëtarët që vijnë nga radhët e pedagogëve dhe 5 të tjerët që zgjidhen me konkurrim të hapur. A mund të njihemi me anëtarët e caktuar dhe ato të përzgjedhurit?

Aida Shehi – Për sa u përket anëtarëve nga jashtë, emra konkretë për momentin nuk kam, sepse kemi pasur edhe një problem me kandidaturat e ardhura dhe ka pasur raste kur një kandidat është tërhequr. Ne kemi bërë një rankim të të gjitha kandidaturave dhe për shkak të këtyre problematikave nuk kemi arritur ta shpallim listimin. Megjithatë, në një moment të dytë ne mund t'ju sjellim një listim.

Ermonela Felaj – E njëjta gjë është edhe për sekretariatit. Unë e kuptoj, por ligji nuk e lidh funksionimin e organeve me momentin e fillimit të trajtimit financiar të tyre. Është e qartë që

anëtarët e Bordit, të Komisionit dhe të sekretariatit do të shpërblehen për punën që bëjnë, ashtu sikundër ligji u ka njohur të drejtën që në përfundim të punës së tyre ata do të kthehen në pozicionet që mbanin ose në pozicionet e ngjashme me to, prandaj nuk e di nëse ka ndonjë arsye tjetër që nuk kemi një listë të anëtarëve, të cilët janë përzgjedhur të jenë pjesë e sekretariatit teknik pranë Bordit?! Ajo është një procedurë që ju e keni kryer, sepse keni intervistuar njerëz dhe keni rankuar. Prandaj dua një përshkrim lidhur me këtë pjesë.

Aida Shehi- Atëherë, ne si Bord kemi përcaktuar kandidatët, duke i renditur sipas pikëve, në bazë të dosjes, të kriterëve të përcaktuara dhe kemi bërë një listim.

Ermonela Felaj- Na përshkruani më hollësisht si u bë shpallja, sa kohë mori intervistimi, sa vetë u paraqitën dhe konkludimi nga ana juaj.

Aida Shehi – Atëherë, në fillim u paraqitën kandidaturat në këto pozicione dhe pas verifikimit në datën 18 qershor u bë shpallja e listës së kandidatëve. Pra, ata të cilët i plotësonin kriteret në bazë të dokumentacionit dhe kërkesave ligjore janë marrë në intervistë për 4 ditë rresht, gjithashtu edhe propozimet e rektoratit.

Ermonela Felaj – Për sa ditë u bë i gjithë intervistimi?

Aida Shehi – 4 ditë.

Ermonela Felaj – Për sa kandidatë?

Aida Shehi - Për rreth 70 kandidatë. 38 intervista për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit dhe 44 për sekretariatit teknik, si dhe 10 kandidaturat e pedagogëve, të cilët morën një ditë më vete. Më pas u bë listimi, i cili nuk është bërë publik për shkak të shqetësimit që paraqesin partnerët ndërkombëtarë, meqenëse nuk po finalizohet akti i pagesës, si dhe verifikimet e tjera të nevojshme.

Ermonela Felaj – A u është bërë i njohur rankimi kandidatëve?

Aida Shehi – Jo, nuk u është bërë i njohur.

Ermonela Felaj – Cilat struktura shtetërore janë njohur me rankimin e Bordit?

Aida Shehi – U është bërë prezent partnerëve ndërkombëtarë, anëtarëve, gjithashtu edhe në diskutim me strukturat, për shkak sepse kërkohej të merrej më shumë informacion.

Ermonela Felaj – Zonja Shehi, ju thatë se keni bërë 12 mbledhje, dua të di se çfarë është konkluduar nga ana e anëtarëve të bordit që ju drejtoni në lidhje me ecurinë e punës, të paktën për atë fazë që ligji ju jep tagër të veproni?

Aida Shehi- Në të gjitha fazat kryesore ka qenë vijueshmëria e procesit, ku fillimisht është përcaktuar procedura, sepse, siç ju thashë, nuk ishte e qartë në ligj sesi do të vijonte Bordi i Përzgjedhjes.

Për sa i përket finalizimit të kësaj pune, ne si Bord kemi kryer dhe kemi ndjekur në mënyrë rigorozë çështjen e respektimit të afateve, sepse anëtarët kanë lënë edhe impenjimet e tyre në institucionet përkatëse, në mënyrë që të mbyllim intervistat. Dëshira jonë ka qenë që ne ta përmbyllim këtë si proces dhe ky ka qenë fakt, koha e ka treguar se anëtarët, të cilët kanë qenë të rankuar për Komisionin e Jashtëm dhe sekretariatit teknik, kanë paraqitur edhe kërkesën për heqje dorë për shkak të impenjimeve të ndryshme që kanë pasur. Ndoshta shkak ka qenë edhe pagesa, e cila nuk ka qenë e qartë. Kjo ishte edhe frika e partnerëve. Domethënë, edhe në nisjen e këtij procesi, duke filluar punën bordi, pa u bërë prezentë çështja e pagesës, sepse kuptohet do të tërhiqen nga një impenjim që mund të kenë në pozicione të ndryshme për të qenë pjesë e një strukture, që është e përkohshme dhe jo e përhershme.

Ermonela Felaj - Të përzgjedhurit për sekretariatit e komisionit të jashtëm, por edhe për vetë anëtarët e komisionit të jashtëm të vlerësimit, si begraund, çfarë përfaqësojnë në shumicë?

Aida Sheshi - Ka përbërje të ndryshme, ka përbërje nga administrata, ka përbërje nga shoqëria civile, kuptohet edhe nga persona që kanë ushtruar funksione të ndryshme, qoftë në administratë, qoftë edhe në aktivitet privat si: avokat, jurist, ekonomist, inxhinier e të tjera, sepse për sekretariatit teknik nuk kishte përkufizime për sa i përket përzgjedhjes, pra mund të kishin shkollim të ndryshëm.

Ermonela Felaj - Po jua kërkoj këtë gjë me shumë respekt, por edhe për hir të transparencës me publikun, mund të na e prezantoni CV-në tuaj profesionale.

Aida Sheshi - Jam juriste dhe kam punuar në administratë shtetërore prej 10 vjetësh, që nga viti 2018 kam filluar në Ministrinë e Brendshme në pozicionin drejtoreshës së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetës.

Ermonela Felaj - Nuk e di nëse kolegët duan të vijojnë me ndonjë një pyetje tjetër, por situata është e qartë: është bërë, le të themi, ndërtimi i strukturës së jashtme, por struktura nuk është ende në kushtet për të filluar punë. A mund ta themi kështu?

Julian Hodaj - Për sa i përket pjesës së procesit që menaxhon Ministria e Brendshme, Ministria e Brendshme është gati që sot që ky organ të fillojë punë, por trajtimi financiar dhe

aspektet e lidhura me të nuk janë të parëndësishme, prandaj kanë marrë edhe kohën që duhet për diskutim dhe trajtim nga organet e ndryshme e shtetërore, që duhet të shprehen për këtë qëllim.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Duke vlerësuar kontributin e zëvendësministrit, sidomos në gjithë këtë projektligj, dua të di: zëvendësministrat kanë të drejtë që të luajnë një rol, qoftë edhe në rolin e vëzhguesit apo të konsultuesit, në proces?

Julian Hodaj – Jo. Le të themi se unë kam pasur privilegjin që të jem drejtues i grupit të punës që hartoi ligjin, që e mbrojti para komisioneve parlamentare dhe që punoj edhe me aspektet e tjera të lidhura me ligjin. Ministria e Brendshme nuk ka zë operativ në proces dhe nuk do të jetë as mbikëqyrëse e procesit. Impenjimi i Ministrisë së Brendshme mbaron në momentin që bordi përzgjedhës merr vendimin final për përzgjedhjen e këtyre 5 anëtarëve të këtyre komisionit të jashtëm dhe 15 anëtarë të sekretariatit teknik mbështes. Në momentin që u sigurohen ambientet e punës dhe baza logjistike e nevojshme, këto janë organe të pavarura, të mbështetura në ligj, të cilat kanë ecurinë e tyre.

Zonja deputete, për dijeni tuaj, meqenëse ma bëtë pyetjen, zëvendësministri i Brendshëm nuk ka qenë fare as i informuar në lidhje me ecurinë e procesit të përzgjedhjes, sepse është një pjesë që ligji ua ngarkon përfaqësuesve të institucioneve.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Ndreu!

Pjerin Ndreu – Kam vetëm një ndërhyrje, duke pasur parasysh edhe sensibilitetin e madh që ka ky proces. Për çdo lloj modifikimi që ju bëni në proces mendoj se duhet të konsultoheni dhe të informoni nënkomisionin për këtë çështje. Çdo paqartësi që ka, meqenëse i përmendët disa, në aplikim dokumentacioni e të tjerë, ne duhet të jemi në dijeni, të informoheni për çdo hap, në mënyrë që të shmangim zgjidhjen e brendshme, por të jetë një zgjidhje e dakordësuar bashkë me ne.

Së dyti, mendoj se rankimi i aplikantëve duhet të bëhet menjëherë publik. Personat duhet ta dinë se çfarë vendi kanë zënë, të parë, të dytë apo të tretë. Në qoftë se i pari nuk fiton për një arsye tjetër, që nuk ka lidhje me intervistën, por mund të ketë lidhje me gjëra të tjera, ky është problem tjetër, a tërhiqet ai, ky është një problem tjetër. Po është e papranueshme për mua që rankimi të mos bëhet publik, sidomos për ata që marrin pjesë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Në fakt, ndërhyrjet e zotit Ndreu, janë të natyrës sugjeruese për të vendosur një metodik pune të këtij nënkomisioni në raport me bordin e përzgjedhjes, por jo vetëm, sepse në vijimësi do të na duhet që t'i vendosim këto raporte me të tria komisionet, me qëllim që të sigurojmë që vetingu, ashtu sikurse e përshkruan, ligji të bëhet deri në fund për të gjithë ata që sot janë pjesë Policisë së Shtetit, e Gardës dhe e SHÇBA-s.

Përpara se t'i ftoj kolegët në propozime konkrete, sugjeroj që në mbledhjen e ardhshme ne të kemi një raport të shkruar të të gjitha zhvillimeve që kanë ndodhur deri tani. Ndërkohë, më duket më se e arsyeshme ndërhyrja e kolegut Ndreu, që emrat e përzgjedhur duhet të bëhen publikë, nuk ka arsye që listat të mos njihen në publik. Po kështu, në bashkëpunim me ju, dua që të vendosim një kalendar pune për mbledhjen e ardhshme, nuk e di sa do e mbështesin kolegët këtë pjesë. Mendoj se do është i nevojshëm një raport i përjavshëm, deri në momentin që struktura fillon nga funksionimi normal, që edhe ne, nga ana jonë, të bëjmë nxitjen tonë pranë organeve që kanë detyrimin për t'u aktivizuar në këtë pikë dhe ta bëjnë të mundur funksionimin e trupave.

Pra, ideja është që të ndërhyjmë në kohën e duhur, sepse kjo është detyra e këtij nënkomisioni. Në qoftë se zëvendësministrit apo ministrit të Brendshëm, ligji nuk u jep tagrin për ta ndjekur procesin, në fakt, këtë tagër e ka marrë parlamenti. Meqenëse sot u kemi ju si drejtuese e bordit përzgjedhës, mendoj se do të na duhet që ta vendosim këtë raport, në mënyrë që ne të jemi të informuar në çdo moment dhe, njëkohësisht, t'i kërkojmë përgjegjësinë e zbatimit të ligjit kujt do që kjo përgjegjësi i takon apo kujt do që kjo përgjegjësi i ka ngelur. Më vjen mirë që ju në një kohë jo shumë të gjatë, gjithsesi duke qenë në detyrat tuaja, nuk e kam fjalën për ju, ju jeni pjesë e Ministrisë së Brendshme, por pjesa tjetër e anëtarëve të bordit nuk janë nga Ministria e Brendshme, por kanë kryer dy detyra paralelisht: edhe detyrën që mbajnë, edhe detyrën që kanë marrë për shkak të këtij ligji dhe keni bërë një numër të konsiderueshëm intervistash, keni bërë përzgjedhjen. Pra, në përgjithësi vërejmë që e keni kryer atë që ju takon.

Po kështu, edhe ministria, nga fjala e zëvendësministrit, vëmë re se është marrë me pjesën logjistike, me pjesën se kudo funksionojë e gjithë kjo trupë, ku do të vendoset sekretariati, kuptohet këtu përfshihen pajisjet me të cilat do të punojnë. Kështu që, duke konsideruar që kjo pjesë nga ana juaj është kryer, atëherë le t'i japim një lëvizje të shpejtë çështjes së trajtimit financiar, në mënyrë që të mos humbasim asnjë ditë më shumë për fillimin e vetingut në radhët e Policisë së Shtetit.

Nuk e di nëse jeni dakord me këtë hyrje apo parantezë që bëra? Dakord.

Urdhëroni, zoti Hodaj!

Julian Hodaj – Jam shumë dakord me atë që tha zoti deputet, në lidhje me raportimin. Zonja kryetare, ajo që ju thatë është e vërtetë, që ligji ia ngarkon këtë tagër këtij nënkomisioni dhe është ky nënkomisioni përgjegjës që e mbikëqyr dhe duhet ta monitorojë ngushtë këtë proces.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjerin Ndreu - Ta sqarojmë, në qoftë se ka një procedurë, që ka vakum dhe duhet interpretuar, mund të konsultoheni edhe me ne. Në qoftë se ka një problematikë, që ne nuk e dimë, mund të na informoni shpejt se si është problemi. Edhe te problemi financiar, ne, si nënkomision, mund të ndërhyjmë. Pra, duke qenë gjithmonë në harmoni me njëri-tjetrin, ne mund të bëjmë më shumë punë. Kjo është ideja.

Julian Hodaj – Absolutisht, nuk po e kundërshtojmë. Deri në momentin që do të jemi gati me sistemimin përfundimtar, sepse kemi një ide të sistemimit të përkohshëm me zyrat dhe godinat, dhe këta 30 veta mund t'i akomodojmë sot, por duke parë se do të jenë 270 veta, besoj se për 1 vit kemi nevojë për një zgjidhje të re. Thashë se Ministria e Brendshme duhet të lidhet me këtë nënkomision dhe të informojë këtë nënkomision në lidhje me atë që po bën për sistemin e logjistikës.

Në lidhje me publikimin e rankimit, që ju sugjeruat, mendojmë se mund të ketë një problem të nivelit teknik, në momentin që bordi do të marrë një vendim të tillë, do ata do të quhen të emëruar. Në momentin që janë të emëruar...

Pjerin Ndreu – Rankimi nuk ka të bëjë me emërim. Në qoftë se vijnë 10 veta, konkurrojnë ti thjesht do të ranksoh, kush është i pari, i dyti, i treti, i gjashti apo i dhjeti, unë këtu e kam fjalën. Më pas se kush emërohet, është proces tjetër. Por në çdolloj aplikimi kjo është detyrueshme që personi ta marrë vesh se i sati ka dalë. Ti si i emëron? Për shembull, unë kam dalë i treti nga ta di unë se kam dal i treti apo i pari?

Ermonela Felaj – A keni ndonjë gjë tjetër, para se ta mbyllim mbledhjen e nënkomisionit.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Dua të theksoj se për ne, anëtarët e nënkomisionit, është e rëndësishme që të paraprakisht të kemi një informacion, në mënyrë që edhe ne të kemi kohën e duhur për të qenë të përgatitur për diskutimet që do të kemi këtu. Sigurisht, është e rëndësishme të kemi diskutime të shpeshta për të evituar edhe probleme që mund të dalin, duke mosparagjykuar dhe

duke qenë të bindur se patjetër trupa është profesionale dhe do ta bëjë punën ashtu siç e përcakton ligji. Faleminderit!

Ermonela Felaj – Sa parashikohet të jetë efekti financiar për bordin, për komisionin e jashtëm të vlerësimit dhe sekretariati? Sa punonjës? A mund ta kemi këtë të dhënë, si nënkomision?

Julian Hodaj – Besoj se për vitin 2018 tashmë efekti është i reduktuar, sepse ishte planifikuar që puna do të fillonte që më 1 qershor, kështu që duhet të detyroheshin të mbuloheshin 6 muaj, por në qoftë se fillon, për shembull, në nëntor, efekti është diku te 12 apo 15 milionë lekë. Në 1 vit ushtrimi normal mendohet se është diku te 400 e ca milionë lekë në total, përfshirë faktin që një pjesë e këtyre shpenzimeve, sepse ju e dini që në fazën tjetër merren si anëtarë të komisioneve të tjera punonjës të Policisë së Shtetit, që tashmë paguhen, është e mbuluar nga buxheti që sot ka në pagat e Policisë së Shtetit. Gjithsesi, besoj se në raportin e shkruar do t'ju japim me detaje edhe koston financiare të të gjithë ushtrimit të këtij aktiviteti.

Ermonela Felaj – Dakord.

Atëherë, ju lutem, përmbylleni raportin, me të gjitha gjërat që u thanë sot, normalisht duke i pasur të gjitha gjërat e sakta, në mënyrë që në mbledhjen paraardhëse ne të jemi më të fokusuar në drejtimin e kësaj çështjeje.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA